



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.214/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga Ferit Osmani kryesues, Rafet Haxhaj dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në Prishtinë, për shkak të vendosjes së sloganit në tabelën e njoftimit publik, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 08.06.2014, mori këtë:

### VENDIM

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), dega në Prishtinë, kështu që subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në Prishtinë, i shqiptohet dënimi më gjohë në lartësi prej 900 (nëntëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.

### Arsyetim

Me datën 06.06.2014, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në Prishtinë, me të cilën pretendon se aktivist të LVV, në tabelën në hyrje të objektit të Kuvendit Komunal të Prishtinës kanë vendosur afishe për njoftim në hapësirën e destinuar për njoftime publike nga komuna.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e nenit 4. 1 pika b të Rregullës Zgjedhore nr.11/2013 dhe 33.1 pika b), vendosja materialeve zgjedhore në hapësirat publike përmban veprim të ndaluar për subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një fotografi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4, paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, dhe nenit 120 paragrafi 1 pika a) të LZP-së, me datë 06.06.2014 e informoi subjektin politik Lëvizje Vetëvendosje (LVV), për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet në ankesë, dhe i ka dhënë Urdhër për të Ndërmarr masat Përmirësuese lidhur me aneksen deri në datë 07.06.2014 në ora 19.00.

Sipas afatit të caktuar, PZAP-i, mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti LVV në të cilën deklaroi se po ashtu kanë kuptuar për vendosjen e etiketave që pretendohet në ankesë ata i kanë hequr ato nga vendi ku ishin të ngjitura, si dhe i kanë bashkangjitur përgjigjes në ankesë fotografit nga vendi ku janë ndërmarr masat përmirësuese, sipas urdhrorit të PZAP-it. Më tutje sipas përgjigjes në ankesë theksohet se ankesa në fjalë nuk

e ka të specifikuar datën dhe kohën se kur ka ndodhur shkelja e supozuar, pasi që nga pretendimi i ankesës nuk mund të vërtetohet koha e shkeljes së supozuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

#### **ankesa është e bazuar**

Nga dëshmitë e ofruar si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se në tabelën hyrëse të kuvendit komunal të Prishtinës nuk është ndonjë shenjë e subjektit politik LVV, por është mbishkrimi i sloganit të subjektit në fjalë me të cilin slogan është duke garuar në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila dispozitë përcakton “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e njoftimeve, pllakateve dhe posterave, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave* ”

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rëndësuese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rëndësuese mori se subjekti politik LVV ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se është i njoftuar me rregullat zgjedhore. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i mori se subjekti politik LVV, pas marrjes së kërkesës për përgjigje në ankesë dhe Urdhrit për të Ndërmarr Masa Përmirësuese, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes duke larguar menjëherë sloganin e tyre nga tabela e njoftimeve të objektit të Kuvendit Komunal të Prishtinës.

PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura se nga ana e subjektit politik LVV është shkelur neni 33 pika b) të LZP-së, pasi që slogani i subjektit në fjalë është mbishkruar në tabelën e Komunës, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të subjektit politik LVV që ka ndërmarrë për evitimin e shkeljes si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të disa fotografive të cilat i ka ofruar si prove të bashkangjitura përgjigjes në ankesë të cilat veprime kanë

ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar, PZAP-i në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr. 214/2014 më datën 08.06.2014.

**Kryesuesi i Panelit**  
**Ferit Osman**



PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*